Nëse një ose më shumë aksionerë heqin dorë nga ushtrimi i të gjithë ose një pjese të së drejtës së parablerjes, pjesa tjetër do të ketë të drejtë të blejë kuotat për shitje për të cilat nuk është ushtruar parablerja, gjithnjë në aksione në përpjestim me investimet përkatëse në shoqëri, dhe me respektimin e procedurës së treguar në paragrafët e mëparshëm.

Në rast se asnjë nga aksionerët nuk ka ndërmend të ushtrojë të drejtën e parablerjes dhe, në rast se numri i pjesëmarrjeve për të cilat parablerja është ushtruar ngelet më e ulët se oferta, parablerja kuptohet që hiqet dorë në tërësinë e saj dhe transferuesi mund t'i shesin subjektit të treguar në letrën e mësipërme, vetë pjesëmarrjen me një çmim që nuk mund të jetë më i ulët se që u ofrohet aksionerëve.

Nëse transferimi me akt mes të gjallëve bëhet me akt të dhurimitose me një shumë tjetër ndryshe nga paratë, ose në rast se çmimi i kërkuar vlerësohet i tepruar nga cilido prej aksionerëve që të ketë shfaqur në afatet dhe në format e përmendura më sipër vullnetin që të ushtrojë të drejtën e parablerjes, çmimi i shitjes do të përcaktohet nga palët me marrëveshje të ndërsjellë. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, çmimi do të përcaktohet nga një raport i betuar i një eksperti i emëruar nga Kryetari i Gjykatës në vendin ku shoqëria ka selinë dhe me kërkesë të palës më të zellshme; në përcaktimin e tij , eksperti do të duhet të marrë parasysh situatën financiare të kompanisë, të të ardhurave që sjell, vlera e asetëve materiale dhe aktivet jo-materiale që normalisht merren në konsideratë për qëllimet e përcaktimit të vlerës së aksioneve të shoqërisë, me vëmendje të veçantë ndaj një "çmimi shumice" të mundshme në rastin e transferimi i paketës së kontrollit të ndërmarrjes;

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193339



E drejta e parablerjes u takon aksionarëve edhe kur është menduar transferojë pronësinë e zhveshur (që gëzohet nga pronari i mëparshëm deri sa të jetë në jetë dhe pastaj transferohet) të aksioneve.

E drejta e parablerjes nuk zbatohet në rastin e pengut ose uzufuktit.

Transferimi i aksioneve hyn në fuqi ndaj shoqërisë nga momenti i regjistrimit të aktit në Regjistrin e Ndërmarrjeve.

KREU III: VENDIMET E AKSINERËVE - ASAMBLEA

NENI 8

Aksionerët vendosin për çështje të rezervuara kompetencës së tyre me ligj, nga ky statut, si dhe për temat që një ose më shumë administratorë ose po qa aksionerë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit aksioner paraqesin për miratim atyre. Në çdo rast, i rezervohet kompetencës së aksionerëve:

- a) miratimin e pasqyrave financiare dhe shpërndarjen e fitimeve,
- b) emërimin e organit administrativ;
- c) emërimin, në rastet e parashikuara nga ligji, të Organit Mbikëqyrës ose të audituesit;
- d) ndryshimet në këtë statut,
- e) vendimi për të kryer transaksione që përbëjnë një modifikim thelbësor të objektit të shoqërisë ose një modifikim i rëndësishëm i të drejtave të aksionerëve
- f) emetimin e letrave me vlerë të borxhit
- g) emërimin e likuiduesve dhe kriteret për kryerjen e likuidimit.

Ata nuk mund të marrin pjesë në vendime, në çfarëdo forme që merren, anëtarët borxhli dhe pronarët e aksioneve për të cilat dispozitat e shprehura të ligjit parashikojnë pezullimin e së drejtës së votës.

NENI 9

Vendimet e aksionerëve, përveçse sa parashikohet në paragrafin e fundit të këtij neni, mund të miratohen me konsultim me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim. Vendimi për mënyrën merret nga organi administrativ.

Nëse vendoset për sistemin e konsultimit me shkrim, duhet të hartohet një dokument specifik me shkrim, nga i cili duhet të jetë i qartë:

- lënda objekt i vendimit,
- përmbajtjen dhe rezultatet e vendimit dhe çdo autorizim i mundshëm pasues nga ai,
- përshkrimi i aksionerëve miratues,
- përshkrimi i aksionerëve kundërshtues ose abstenues, dhe me kërkesë të tyre, përshkrimi i arsyes për kundërshtimin ose abstenimin e tyre,
- nënshkrimi i të gjithë aksionerëve, si miratues, ashtu edhe abstenues dhe kundër,

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193339



Nëse vendosni për sistemin e miratimit të shprehur me shkrim, duhet të hartohet një dokument specifik me shkrim nga i cili duhet të jetë i qartë:

- lënda objekt i vendimit,
- përmbajtjen dhe rezultatet e vendimit dhe çdo autorizim i mundshëm pasues nga ai,

Një kopje e këtij dokumenti duhet t'u dërgohet të gjithë aksionerëve të cilët, brenda pesë ditëve në vijim, duhet t'i dërgojnë shoqërisë një deklaratë të posaçme, të shkruar në fund të kopjes së dokumentit të marrë, në të cilën ata duhet të shprehin votën e tyre pro ose kundër ose abstenim, duke përshkruar, nëse gjykohet e përshtatshme, arsyen e kundërshtimit ose abstenimit të tyre, mungesa e deklaramit nga aksionerët brenda afatit të sipërpërmendur është e barabartë me një votë kundër.

Dërgimet e parashikuara në këtë nen mund të bëhen me çdo mjet dhe / ose sistem komunikimi që lejon një konfirmim të dërgesës dhe marrjes, përfshirë faksin dhe postën elektronike.

Secili aksioner ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet e përmendura në këtë nen dhe vota e tij është e vlefshme në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tij.

Vendimet e aksionerëve merren me votën pro të shumicës që përfaqëson të paktën gjysmën e kapitalit aksionar. Në lidhje me çështjet e përshkruara në nenin e mëparshëm në pikat d) e) f) dhe g), në të gjitha rastet e tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji ose nga ky statut, ose kur një ose më shumë administratorë ose një numër aksionerësh që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit aksionar, vendimet e aksionerëve duhet të miratohen me vendime asambleje në përputhje me metodën kolegjiale.

NENI 10

Asambleja e aksionerëve thirret nga organi Administrativ.

Normalisht asambltetë zhvillohen në selinë e shoqërisë, por mund të zhvillohen edhe në vende të tjera, brenda territorit kombëtar.

NENI 11

Thirrja e asamblesë bëhet me letër rekomande me përgjigje kthimi që përmban rendin e ditës, orën, ditën dhe vendin e mbledhjes, për t'ia dërguar aksionerëve, në vendbanimin që rezulton nga Regjistri i Ndërmarrjeve në përputhje me nenin 2479 bis të Kodit Civil Italian, administratorëve dhe Organit Mbikëqyrës nëse emërohen, të paktën tetë ditë para vetë mbledhjes.

Në njoftimin e thirrjes, një datë e mëtejshme e thirrjes së dytë mund të parashikohet në rast se mbledhja e aksionerëve nuk konstituohet ligjërisht në mbledhjen e parashikuar në thirrjen e parë.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193333



Njoftimi i thirrjes mund t'u dërgohet aksionerëve dhe administratorëve, dhe Organit Mbikëqyrës nëse është caktuar, gjithashtu me e-mail ose tele-faks në vendin dhe në adresën e postës elektronike ose numrin e përdoruesit të tele-faksit të komunikuar nga ata te shoqëria, duke u nënkuptuar që aksionerët të cilët nuk kanë ndër mend të tregojnë një përdorues të faksit ose një adresë e-mail, ose që revokojnë përshkrimin e bërë më parë, kanë të drejtë të marrin komunikimin me letër rekomande.

I takon kryetarit të konstatojë konstituimin e rregullt të saj, të vërtetojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të drejtojë dhe rregullojë sjelljen e asamblesë dhe të konstatojë dhe shpallë rezultatet e votimeve. Kryetari ka të drejtë të formulojë propozime për vendime dhe të diskutojë rendin e ditës. Asambleja e aksionerëve mund të zhvillohet gjithashtu me ndërhyrje të vendosura në disa vendndodhje të lidhura me audio video, në përputhje me kushtet e mëposhtme, të cilat duhet të shënohen në procesverbalin përkatës:

- që kryetari dhe sekretari i mbledhjes të jenë të pranishëm në të njëjtin vend, të cilët do të përgatisin dhe nënshkruajnë procesverbalin;
- që kryetarit të asamblesë i lejohet të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, zhvillimin e rregullt e mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit;
- që personit që merr procesverbalin i lejohet të perceptojë në mënyrën e duhur ngjarjet e takimit që i nënshtrohen procesverbalit;
- që të pranishmit të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe votim të njëkohshëm për pikat në rendin e ditës, si dhe të shikojnë, marrin ose transmetojnë dokumente;
- që vendet audio dhe video të lidhura nën kujdesin e shoqërisë të tregohen në njoftimin e thirrjes, përveçse në rastin e një mbledhje totalitare, në të cilën të pranishmit mund të marrin pjesë, takimi konsiderohet të ketë ndodhur në vendin ku kryetari dhe personi që mban procesverbalin.

Takimi i aksionerëve mund të mbledhet në mënyrë të vlefshme edhe në mungesë të formaliteteve të sipërpërmendura, nëse i gjithë kapitali aksioner është i pranishëm ose i përfaqësuar, të gjithë administratorët dhe Organi Mbikëqyrës nëse janë caktuar, ose administratorët dhe Organi Mbikëqyrës informohen për mbledhjen dhe asnjë nga ta kundërshton diskutimin e argumenteve.

Nëse administratorët ose Organi Mbikëqyrës, nëse emërohen, nuk marrin pjesë personalisht në mbledhje, ata duhet të lëshojnë një deklaratë të posaçme me shkrim, që do i paraqitet Kryetarit të asamblesë dhe që do të mbahet në regjistrat e shoqërisë në të cilën ata deklarojnë se ata janë të informuar për të gjitha çështjet e ngritura në rendin e ditës dhe nuk i kundërshtojnë ato.

NENI 12



Asambleja drejtohet në varësi të strukturës së organit administrativ, nga administratori i vetëm ose nga kryetari i bordit të administrimit ose nga administratori më i vjetër.

Në mungesë të tyre, personi i zgjedhur nga asambleja me votën e shumicës së të pranishmëve do të veprojë si president .

Kryetari ndihmohet nga një sekretar i caktuar nga asambleja, i zgjedhur gjithashtu nga jo-aksionerët.

NENI 13

Secilit aksioner i takon një numër votash në proporcion me pjesëmarrjen e tij . E drejta për të marrë pjesë në mbledhje rregullohet me ligj. Çdo aksioner që ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje mund të përfaqësohet me prokurë me shkrim, prokurë që duhet të ruhet nga shoqëria.

Prokura nuk mund të lëshohet bosh me emrin e përfaqësuesit . Përfaqësuesi mund të zëvendësohet vetëm nga ata që shprehen shprehimisht në prokurë. Nëse prokura jepet për takimin e vetëm, ajo gjithashtu ka efekt për thirrjet pasuese.

Prokura nuk mund t'i jepet një administratori të shoqërisë ose Organit Mbikëqyrës nëse emërohet dhe as punonjësve të ndërmarrjes.

Asambletë, si në thirrjen e parë ashtu edhe në atë të dytë, janë konstituuar në mënyrë të vlefshme dhe vendosin me kuorumin e parashikuar nga neni 2479 bis të Kodit Civil Italian, me përjashtim të rasteve të mëposhtme për të cilat kërkohet vota pro e aq aksionerëve aq sa përfaqësojnë 51% të kapitalit aksioner :

- vendimet në lidhje me vazhdimin dhe likuidimin e aksioneve të aksionarit të ndjerë;

- vendime në lidhje me miratimin në hipotezën e shitjes së aksioneve me akt mes të gjallësh.

Sidoqoftë, mbeten dispozitat e tjera të këtij statuti, të cilat kërkojnë shumicë të ndryshme specifike për vendime të veçanta.

NENI 14

Vendimet e asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal të nënshkruar nga kryetari dhe sekretari ose nga noteri.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e mbledhjes dhe, gjithashtu në një shtojcë, identitetin e pjesëmarrësve dhe kapitalin themelor të përfaqësuar nga secili, gjithashtu duhet të tregojë metodat dhe rezultatet e votimit dhe duhet të lejojë, gjithashtu edhe bashkëngjitur, identifikimin e aksionerëve pro, abstenim ose kundër. Në procesverbal duhet të përmbledhen, me kërkesën e aksionerëve, deklaratat e tyre në lidhje me rendin e ditës.

Procesverbalet në lidhje me vendimet e mbledhjes së aksionerëve që përfshijnë ndryshimin e këtij statuti duhet të hartohen nga një noter.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193339

Procesverbali i mbledhjes, edhe nese është përpiluar me akt publik, duhet të transkriptohet, pa vonesë, në librin e vendimeve të aksionarëve.

KREU IV : ADMINISTRIMI NENI 15

Shoqëria mund të administrohet në alternative, në përputhje me atë që është vendosur nga aksionerët në momentin e emërimit:

- nga një Administrator i Vetëm,
- nga një këshill administrimi i përbërë nga një numër anëtarësh që varion nga një minimum prej dy deri në një maksimum prej pesë, sipas numrit të saktë që do të përcaktohet nga aksionerët në momentin e emërimit;
- nga dy ose më shumë administratorë me kompetenca të përbashkëta dhe / ose të ndara, në numrin dhe me kompetencat që do të përcaktohen nga aksionerët në momentin e emërimit të tyre.

Administratoret mund të jenë edhe jo-aksionerë. Ata nuk mund të emërohen në pozicionin e Administratorit dhe nese emërohen, largohen nga detyra ata që gjenden në kushtet e parashikuara nga neni. 2382 kod. civile

NENI 16

Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në revokim ose dorëheqje ose për atë kohë më të kufizuar që do të përcaktohet nga aksionerët në momentin e emërimit të tyre .

Në rast të një emërimi deri në revokim ose dorëheqje, revokimi i administratorëve lejohet në çdo kohë dhe pa nevojë për motivim, ose me shkak te arsyeshëm.

Lejohet rizgjedhja.

Nëse Këshilli i Administrimit është emëruar, nëse për ndonjë arsye shumica e administratorëve pushon së ekzistuari, i gjithë Këshilli i Administrimit bie. Nëse, nga ana tjetër, janë emëruar disa administratorë, me kompetenca të përbashkëta dhe / ose të ndara, nëse për ndonjë arsye edhe një administrator i vetëm përfundon, administratorët e tjerë gjithashtu bien .

Do të varet nga aksionerët me vendimin e tyre për të vijuar me emërimin e organit të ri administrativ. Në ndërkohë, Këshilli i rënë ose administratorët e tjerë të rënë do të jenë në gjendje të kryejnë vetëm veprimet e administrimit të zakonshëm.

Përfundimi i administratorëve për shkak të përfundimit të mandatit hyn në fuqi nga momenti në të cilin është rindërtuar organi i ri administrativ.

NENI 17

Nëse kompania drejtohet nga një Këshill Administrimi, ky zgjedh një President nga radhët e anëtarëve të saj, nëse ai nuk emërohet nga aksionerët në momentin e

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193339



emërimit, dhe mundësisht edhe një nënkryetar i cili zëvendëson presidentin në rast mungese ose pengese, si dhe një sekretar, madje edhe një i jashtëm.

NENI 18

Nëse kompania administrohet nga një Këshill Administrimi, vendimet e tij, përveç sa parashikohet në nenin vijues 19 miratohen me konsultë me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim, në përputhje me atë që do të vendoset nga vetë Këshilli në mbledhjen e parë pas emërimit.

Nëse kompania administrohet nga një Këshill Administrimi, vendimet e tij, përveç sa parashikohet në nenin vijues 19 miratohen me konsultë me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim, në përputhje me atë që do të vendoset nga vetë Këshilli në mbledhjen e parë pas emërimit.

Nëse vendoset për sistemin e konsultimit me shkrim, duhet të hartohet një dokument specifik me shkrim, nga i cili duhet të jetë i qartë:

- lënda objekt i vendimit,
- përmbajtjen dhe rezultatet e vendimit dhe çdo autorizim i mundshëm pasues mga ai,
- përshkrimi i administratorëve miratues,
- përshkrimi i administratorëve kundërshtues ose abstenues, dhe me kërkesë të tyre, përshkrimi i arsyes për kundërshtimin ose abstenimin e tyre,
- nënshkrimi i të gjithë administratorëve, si miratues, ashtu edhe abstenues dhe kundër,

Nëse vendosni për sistemin e miratimit të shprehur me shkrim, duhet të hartohet një dokument specifik me shkrim nga i cili duhet të jetë i qartë:

- lënda objekt i vendimit,
- përmbajtjen dhe rezultatet e vendimit dhe çdo autorizim i mundshëm pasues mga ai,

Një kopje e këtij dokumenti duhet t'u dërgohet të gjithë aksionerëve të cilët, brenda pesë ditëve në vijim, duhet t'i dërgojnë shoqërisë një deklaratë të posaçme, të shkruar në fund të kopjes së dokumentit të marrë, në të cilën ata duhet të shprehin votën e tyre pro ose kundër ose abstenim, duke përshkruar, nëse gjykohet e përshtatshme, arsyen e kundërshtimit ose abstenimit të tyre, mungesa e deklaramit nga administratorët brenda afatit të sipërpërmendur është e barabartë me një votë kundër. Dërgimet e parashikuara në këtë nen mund të bëhen me çdo mjet dhe / ose sistem komunikimi që lejon një konfirmim të dërgesës dhe marrjes, përfshirë faksin dhe postën elektronike.

Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me votën e favorshme të shumicës së administratorëve në detyrë.

Vendimet e administratorëve të miratuara në përputhje me këtë nen duhet të transkriptohen në librin e vendimeve të drejtorëve.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTOREGIURATO
0698193339



Me shumicat e lartpërmendura, administratorët mund të vendosin të shtyjnë vendimin për çështje të veçanta ose për transaksione specifike në zgjidhjen e këshillit të administrimit që do të miratohet me metodën kolegjiale.

NENI 19

Në lidhje me çështjet e përmendura në nenin 2475 paragrafi i pestë i Kodit Civil Italian ose në rastin e përmendur në paragrafin e fundit të nenit 18 sa më lart, ose në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji ose nga ky statut, vendimet e këshillit të administrimit duhet të miratohen me vendim kolegjial.

Për këtë qëllim, këshilli i administrimit:

- thirret nga Presidenti me anë të një njoftimi të dërguar me letër të regjistruar, ose me ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm për qëllimin (për shembull faks, e-mail), të paktën tre ditë para takimit dhe në rast urgjence me telegram ose faksi që do të dërgohet së paku një ditë përpara, në të cilën përcaktohet data, vendi dhe koha e takimit, si dhe rendi i ditës;

- mbledhet në selinë e shoqërisë ose diku tjetër, për sa kohë që është brenda territorit kombëtar, ose në një shtet tjetër që i përket Bashkimit Evropian.

Takimet e këshillit dhe vendimet e tij janë të vlefshme, edhe pa thirrje formale, kur marrin pjesë të gjithë administratorët në detyrë dhe Organi Mbikëqyrës nëse është emëruar.

Takimet e këshillit të administrimit gjithashtu mund të mbahen me audio konferencë ose video konferencë, në kushtet e mëposhtme të cilat do të shënohen në procesverbalin përkatës:

a. që kryetari dhe personi që merr procesverbalin janë të pranishëm në të njëjtin vend, të cilët do të përgatisin dhe nënshkruajnë procesverbalin, takimi do të konsiderohet se është zhvilluar në atë vend;

b. që kryetarit të mbledhjes t'i lejohet të konstatojë identitetin e të pranishmëve, të zhvillimin e rregullt të mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit;

c. që personi që merr procesverbalet lejohet të perceptojë në mënyrën e duhur ngjarjet e takimit objekt procesverbali;

d. që të pranishmit të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe votim të njëkohshëm për pikat në rendin e ditës, si dhe të shikojnë, marrin ose transmetojnë dokumente. Këshilli i administrimit vendos në mënyrë të vlefshme, në formë kolegjiale, me praninë efektive të shumicës së anëtarëve të tij në detyrë dhe një shumicë absolute të votave të të pranishmëve.

Në rast barazimi, propozimi konsiderohet i refuzuar. Votimi nuk mund të jepet me përfaqësim.

Vendimet e këshillit të administrimit të miratuara në përputhje me këtë nen regjistrohen në procesverbalin e nënshkruar nga kryetari dhe sekretari, dhe ky

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193399





procesverbal, edhe nëse hartohet me akt publik, duhet të transkriptohet në librin e vendimeve të administratorëve.

NENI 20

Organi administrativ, cilado qoftë struktura e tij, ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, duke përjashtuar ato që ligji ose ky statut u rezervon shprehimisht aksionerëve.

Në rast të emërimit të këshillit të administrimit, ky mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij në përputhje dhe brenda kufijve të përcaktuar në nenin 2381 të Kodit Civil Italian një komiteti ekzekutiv të përbërë nga disa prej anëtarëve të tij ose një ose më shumë anëtarëve të tij, madje edhe veçmas. Komiteti ekzekutiv ose administratori ose administratorët e deleguar, do të mund të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm që do të rezultojnë nga delegimi i dhënë nga këshilli i administrimit, me kufizimet dhe me mënyrat e përcaktuara në vetë delegimin.

Në rast të emërimit të disa administratorëve, me kompetenca të përbashkëta dhe / ose të ndara, kompetencat e administrimit, me rastin e emërimit, mund t'i atribuohen bashkërisht dhe veçmas, ose pra disa kompetenca të administrimit mund t'i atribuohen veçmas dhe të tjerat bashkërisht. Në mungesë të ndonjë specifikimi në aktin e emërimit në lidhje me procedurat për ushtrimin e kompetencave të administrimit, këto kompetenca do të kuptohet si atribuar administratorëve së bashku.

Nëse administrimi u besohet veçmas disa administratorëve, në rast kundërshtimi nga një administrator për veprimin që një tjetër synon të kryejë, aksionerët janë kompetentë të vendosin për kundërshtimin.

Organi administrativ mund të caktojë drejtorë, drejtues dhe përfaqësues të posaçëm për kryerjen e disa veprimeve ose kategorive të veprimeve, duke përcaktuar kompetencat e tyre.

NENI 21

Administratorët kanë përfaqësimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

Në rast të emërimit të këshillit të administrimit, përfaqësimi i shoqërisë do t'u caktohet të gjithë anëtarëve të këshillit të administrimit, veçmas nga njëri-tjetri.

Në rast të emërimit të disa administratortëve, me kompetenca të përbashkëta dhe / ose të ndara, përfaqësimi i përket atyre vetë bashkërisht ose veçmas në varësi të kompetencave të administrimit, në rast emërimi, që u janë atribuar atyre bashkërisht ose veçmas .

Përfaqësimi i shoqërisë i përket gjithashtu edhe drejtorëve, drejtuesve dhe përfaqësuesve të posaçëm brenda kufijve të kompetencave të përcaktuara nga organi administrativ në aktin e emërimit.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTOREGIURATO
 0698193339

NENI 22

Përveç rimbursimit të shpenzimeve të bëra për ushtrimin e funksioneve të tyre, administratorëve mund t'u caktohet një pagësë e përgjithshme vjetore, edhe në formën e ndarjes së fitimit, i cili do të përcaktohet nga aksionerët, me rastin e emërimit të tyre ose me një vendim specifik .

Nëse shoqëria drejtohet nga një këshill administrimi, pagesa e administratorëve të caktuar me detyra të veçanta përcaktohet nga vetë këshilli, pasi ka dëgjuar mendimin e Organit Mbikëqyrës nëse është caktuar.

Organit administrativ gjithashtu mund t'i jepet e drejta për të marrë një pagesë për përfundimin e një marrëdhënieje të koordinuar dhe të vazhdueshme bashkëpunimi , që do të vendoset përmes lënive mënjanë vjetore ose përmes një police sigurimi.

KREU V : BILANCET FINANCIARE DHE FITIMET

NENI 23

Vitet fiskale do të mbyllen më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti financiar, organi administrativ do të përgatisë bilancin shoqëror në përputhje me ligjin.

Bilancet financiare duhet t'u paraqiten aksionerëve brenda njëqind e njëzet ditëve nga përfundimi i vitit financiar, ose brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve kur shoqërisë i kërkohet të hartojë bilancet financiare të konsoliduara ose nëse nevoja të veçanta të sa e kërkojnë në përputhje me dispozitat e neneve 2364 dhe 2478 bis të Kodit Civil: në rastin e fundit , megjithatë, administratorët duhet të tregojnë në raportin e tyre (ose në shënimin shpjegues në rastin e një deklaratë të shkurtuar financiare) arsyet e shtrirjes.

Një shumë që do t'i caktohet rezervës ligjore duhet të zbritet nga fitimet neto që rezultojnë nga bilancet financiare brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar nga neni 2430 i Kodit Civil Italian ose nga neni 2463 paragrafi V i Kodit Civil Italian.

Vendimi i aksionerëve që miratojnë bilancet financiare vendos për shpërndarjen e fitimeve.

Vetëm fitimet e arritura në të vërtetë dhe që rezultojnë nga pasqyrat financiare të miratuara rregullisht mund të shpërndahen , pas zbritjes së pjesës së destinuar në rezervën ligjore.

Nëse ka një humbje të kapitalit shoqëror, nuk mund të ketë shpërndarje të fitimeve derisa kapitali të rivendoset ose të zvogëlohet proporcionalisht.

Shpërndarja paradhënie e fitimeve nuk lejohet.

KREU VI : ORGANI MBIKERQYRS – AUDITUESI LIGJOR I LLOGARIVE

NENI 24

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTOREGIURATO
0698193339





Shoqëria mund të emërojë, duke përcaktuar kompetencat dhe fuqitë, përfshirë auditimin ligjor të llogarive, një organ kontrolli ose një auditues ligjor.

Organi i kontrollit gjithashtu mund të përbëhet nga vetëm një anëtar efektiv.

Emërimi i organit të kontrollit ose audituesit është i detyrueshëm nëse shoqëria:

- a) i kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara;
- b) kontrollon një shoqëri të detyruar të kryejë auditimin ligjor;
- c) për dy vite financiare rresht ka tejkalar dy nga kufijtë e përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 2435-bis të Kodit Civil Italian. Detyrimi pushon nëse, për dy vite financiare rresht, nuk tejkalohen dy nga kufijtë e lartpërmendur.

Në rast të emërimit të një organi kontrolli, qoftë edhe me një person, zbatohen dispozitat mbi bordin e audituesve ligjorë të parashikuara për shoqëritë aksionere.

Në rast se organi i kontrollit kryen edhe funksionin e auditimit ligjor të llogarive, ky organ duhet domosdoshmërisht të përbëhet nga persona të cilët përveçse kanë të njëjtat kriteret profesionale siç parashikohen nga neni 2397, paragrafi 2, K.C. për audituesit ligjorë të Sh.A-ve, duhet të zgjidhen midis audituesve ligjorë të regjistruar në regjistrin përkatës, në zbatim të dispozitave të nenit 2409-bis të Kodit Civil Italian.

Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, nëse është caktuar, mund të kryejë vetëm aktivitete auditimi që synojnë të verifikojnë mbajtjen e rregullt të llogarive sociale dhe regjistrimin korrekt të fakteve të menaxhimit në regjistrat e kontabilitetit, si dhe shprehjen e mendimit të tyre për pasqyrat financiare të vitit financiar.

Mbledhjet e organit mbikëqyrës gjithashtu mund të mbahen me anë të mjeteve të telekomunikacionit; në këtë rast, zbatohen dispozitat e përcaktuara në këtë statut në lidhje me organin administrativ.

KREU VII : SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI NENI 25

Shoqëria shpërbëhet për arsyet e parashikuara nga ligji dhe për këtë arsye: për mbarimin e afatit;

për arritjen e qëllimit të shoqërisë ose për pamundësinë e papritur për ta arritur atë, përveçse nëse asambleja e aksionerëve, e thirrur për këtë qëllim brenda 30 ditësh, nuk miraton ndryshimet e duhura në statutin e shoqërisë;

për pamundësinë e funksionimit ose për pasivitetin e vazhdueshëm të asamblesë;

për uljen e kapitalit themelor nën minimumin ligjor, pa cenuar dispozitat e nenit 2482 ter të Kodit Civil;

në hipotezën e parashikuar nga neni 2473 i Kodit Civil;

me vendim të asamblesë;

për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj.

Në të gjitha rastet e shpërbërjes, organi administrativ duhet të përmbushë detyrimet reklamuese të kërkuara nga ligji brenda 30 ditëve nga verifikimi i tyre.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193339



Asambleja, nëse është i thirrur nga organi administrativ, do të emërojë një ose më shumë likuidues duke përcaktuar:

- numrin e likuiduesve;
- në rastin e disa likuiduesve, rregullat për funksionimin e kolegjit, gjithashtu duke iu referuar funksionimit të këshillit të administrimit, për aq sa ato janë në përputhje;
- kush është përgjegjës për përfaqësimin e ndërmarrjes;
- kriteret në bazë të të cilave duhet të bëhet likuidimi;
- kufizimet e mundshme të kompetencave të organit likuidues.

KREU VIII : HEQJE DORË (TËRHEQJE)

NENI 26

E drejta e tërheqjes u takon aksionerëve në të gjitha rastet e parashikuara me ligj ose me këtë Statut.

Synimi i aksionerit për të ushtruar të drejtën e tërheqjes duhet t'i komunikohet organit administrativ me letër rekomande me vërtetimin e marrjes brenda 15 ditëve nga regjistrimi në Regjistrin e Ndërmarrjeve të vendimit që legjitimon të drejtën e tërheqjes; nëse fakti që legjitimon tërheqjen është i ndryshëm nga një vendim që do të regjistrohet në Regjistrin e Ndërmarrjeve, ajo ushtrohet brenda 30 ditëve nga njohja e saj nga ana aksionerit. Investimet në kapital për të cilat ushtrohet e drejta e tërheqjes nuk mund të shiten.

Tërheqja nuk mund të ushtrohet dhe, nëse është ushtruar tashmë, është joefektive kur kompania revokon vendimin që e legjitimon atë ose nëse mbledhja e aksionerëve shpërbën shoqërinë.

Aksionerët që tërhiqen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin rimbursimin e aksioneve të tyre në proporcion me kapitalin aksioner të përcaktuar duke marrë parasysh situatën financiare të kompanisë, fitmietet e saj, vlerën e aktiveve materiale dhe jo-materiale në pronësi të saj, pozicionin e saj në treg dhe çdo rrethanë dhe kusht tjetër që normalisht merret në konsideratë për qëllimin e përcaktimit të vlerës së tregut të aksioneve të shoqërisë; në rast mosmarrëveshjeje, përcaktimi bëhet në bazë të një raporti të betuar të hartuar nga një ekspert i caktuar nga Kryetari i Gjykatës në përputhje me ligjin me kërkesë të palës më të zellshme.

Rimbursimi duhet të bëhet në mënyrën e përcaktuar me ligj brenda 180 ditëve nga komunikimi i vullnetit të tërheqjes.

Rimbursimi mund të bëhet gjithashtu përmes blerjes nga aksionerët e tjerë në proporcion me aksionet e tyre ose nga një palë e tretë e identifikuar nga të njëjtët aksionarë. Në këtë rast, organi administrativ duhet t'u ofrojë të gjithë aksionerëve, pa vonesë, blerjen e aksioneve të atij që tërhiqet. Nëse blerja nga aksionerët ose një palë e tretë e identifikuar prej tyre nuk kryhet, rimbursimi bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose, në mungesë, duke ulur përkatësisht kapitalin aksionar; në rastin e fundit do të zbatohet neni 2482 i Kodit Civil Italian. Sidoqoftë,

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193339

nëse pas rimbursimit të aksionit të aksionerit të tërhequr nga shoqëria, kapitali themeltar duhet të ulet nën minimumin ligjor, organi administrativ duhet të thërrasë pa vonesë aksionerët e mbijetuar në mënyrë që t'i lejojë ata të marrin masa në proporcion me aksionet përkatëse, me kontributet e nevojshme për të rindërtuar kapitalin për një shumë jo më të vogël se minimumi ligjor ose ata do të duhet të parashikojnë transformimin ose shpërbërjen e kompanisë.

KREU IX °: KLAUZOLA E ARBITRIMIT DHE NORMA E REFERENCËS NENI 27

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis aksionerëve ose midis aksionerëve dhe shoqërisë në lidhje me të drejtat e disponueshme në lidhje me marrëdhëniet shoqërore, me përjashtim të atyre në të cilat ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të prokurorit , duhet të zgjidhet nga një arbitër i caktuar nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë në Treviso, i cili duhet të bëjë emërimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kërkesa e bërë nga pala më e shpejtë. Në rast se subjekti i caktuar nuk e bën këtë brenda afatit të parashikuar, pala më e zellshme do të kërkojë emërimin nga Kryetari i Gjykatës së vendit ku shoqëria ka selinë .

Selia e arbitrazhit do të jetë në vendbanimin e arbitrit.

Arbitri duhet të vendosë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga emërimi.

Arbitri do të vendosë në rrugë jo rituale, sipas barazisë. Mbetet e përcaktuar që tani në mënyrë të pakthyeshme që tani e tutje që rezolutat dhe vendimet e arbitrit do jenë detyruese për palët. Shpenzimet e arbitrazhit do të përballohen nga pala humbëse përveç nëse vendoset ndryshe nga arbitri.

Mosmarrëveshjet e filluara nga administratorët, likuiduesit dhe organi mbikëqyrës, ose ato të ngritura kundër tyre që kanë si objekt të drejtat e tyre të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e shoqërisë, gjithashtu i nënshtrohen rregullave të parashikuara më sipër .

Anullimi e kësaj klauzole arbitrazhi duhet të miratohet me shumicën e të paktën dy të tretave të kapitalit aksioner.

Anëtarët që mungojnë ose kundërshtojnë mund të ushtrojnë të drejtën e tërheqjes brenda 90 ditëve në vijim .

NENI 28

Për sa nuk parashikohet shprehimisht në këtë statut dhe akt themelimi , zbatohen dispozitat e ligjit.

Nënshkruar QARRI ALMA

Nënshkruar ADA STIZ (Is)

Kjo kopje e shtrire në 10 faqe është në përputhje me aktin tim origjinal dhe bashkëngjitur.

Lëshohet kopje konforme

Treviso, me 26 maj 2021.

Firma

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193339



APOSTILE

Konventa e Hagës e dates 5 tetor 1961

1. Shteti: Itali
2. Ky akt publik
3. Është nënshkruar nga Ada Stiz
4. Agjent në cilësinë e Noterit
4. Është shënjuar me vulën e Noterit ne Treviso
5. Në Treviso
6. Me 04.06.2021
7. Nga Prokurori i Republikës
8. Me numër 827
9. Vula
10. Firma



VËRTETUAR

Deklaroj që ky përkthim është konform me tekstin origjinal në gjuhën italiane dhe është përkthyer nga përkthyesi i betuar i Ministrisë së Drejtësisë Klodian Kovaçi.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193339